



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK), në mbështetje të nenit 21, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.2 ; nenit 27, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.2 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, në takimin e mbajtur me 11.05.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet kërkesa e Sekretarit të Përgjithshëm të OSK-së me nr. Prot. 1872 të dt. 07.05.2021 për ndrimin e lokacionit të OSK-së.
- II. Autorizohet Sekretari i Përgjithshëm i OSK-së, Z. Agron Kabashi t'i kryen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe teknike lidhur me ndrimin e lokacionit të OSK-së, duke i zbatuar aktet normative të Odës në fuqi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Oda e Stomatologëve të Kosovës ka filluar shërbimet për anëtarët e saj nga viti 2017 në hapësirat punuese në të cilat edhe sot ushtron veprimtarinë. Hapësirat aktuale në kontinerat e MPBAP –së në të cilat OSK është duke ushtruar funksionin janë të papërshtatshme dhe jo të sigurta për funksionet dhe kompetencat të cilat është duke ushtruar Oda e Stomatologëve aktualisht, ka mungesë të hapësirave ku nga dy hapësira aktuale të njëjtat po shfrytëzohen edhe për punën e organeve e edhe për stafin aktual. Po ashtu kushtet higjienike sanitare nuk përmbushin as minimumin e kritereve të pastërtisë duke rrezikuar edhe infeksione të mundëshme nga këto.

Duke u bazuar në këtë Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi

Kryesuesi i Këshillit Drejtues OSK-së
Prof.Dr. Blerim Kamberi

